



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 1 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat

Prokurorit të Specializuar

Jack Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	3
III.	DISKUTIM	4
A.	PARIMET E PROCESIT TË PARAQITJES SË KËRKESAVE PËR PRANIM SI VIKTIMË	4
B.	INFORMACIONI QË U JEPET PERSONAVE QË DUAN TË PARASHTROJNË KËRKESË.....	6
C.	MBLEDHJA E KËRKESAVE	7
D.	DORËZIMI I KËRKESAVE.....	8
E.	VLERËSIMI I KËRKESAVE.....	14
1.	Pranueshmëria e kërkesave.....	14
2.	Ndarja në grupe e parashtruesve të kërkesave	20
3.	Masat mbrojtëse	22
F.	ROLI I PALËVE NË PROCESIN E PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE.....	24
G.	MJETET JURIDIKE PËR KËRKESAT E REFUZUARA	26
	VENDIM.....	26

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 22(1), 34(6), 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 23(5), 95(2)(i) dhe 113 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e Aktakuzës (“Vendimi i Konfirmimit”),² Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, Pjetër Shala (“z. Shala” ose “i akuzuari”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).⁴
3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁵
4. Më 19 prill 2021, z. Shala pati paraqitjen e tij të parë⁶ para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i këtij vendimi u nxor më 6 maj 2021, F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 31 mars 2021, F00016/A02.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00019/RED, Administratorja, *Version i redaktuar publik i ‘Njoftimit për pranimin e Pjetër Shalës në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për caktimin me kusht të mbrojtësit’, parashtrimi i protokolluar F00019 i datës 15 prill 2021, 26 prill 2021, publik, me shtojcat 1-2, konfidenciale.*

⁶ KSC-BC-2020-04, F00020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë të Pjetër Shalës dhe çështje të lidhura me të*; 15 prill 2021, publik; KSC-BC-2020-04, Transkript, 19 prill 2021, publik, f. 1.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit dhe me rregullën 2 të Rregullores, viktimja është personi fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale që bie brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

6. Në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një veprë penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces ("VPP"), ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se i ka shkaktuar dëm.

7. Në pajtim me nenin 34(6) të Ligjit dhe rregullën 23(5) të Rregullores, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV"), ndër të tjera, administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave siç parashikohet në nenin 22 të Ligjit dhe Rregullores. ZPV-ja ndihmon dhe këshillon viktimat pjesëmarrëse në proces ("VPP").

8. Në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe shqyrton kërkesat dhe ia dorëzon ato Gjykatësit të Procedurës Paraprake së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit.

9. Në pajtim me rregullën 113(1)-(3) të Rregullores, formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve dhe ato marrin vetëm një raport konfidencial të parashtrimit të ZPV-së, në bazë të të cilit mund të bëjnë parashtrime në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

10. Në përputhje me rregullën 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të përfshirë në Aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon

pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vendos në lidhje me përfaqësimin e përbashkët dhe çdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

11. Në përputhje me nenin 22(4) të Ligjit, VPP-të formojnë një grup, përveç rasteve kur paneli urdhëron që ato duhet të ndahen në më shumë se një grup. Në përputhje me rregullën 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në konsultim me ZPV-në, vendos nëse do t'i ndajë VPP-të në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh çfarëdo konflikti interesash që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët, çfarëdo interesash të ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët, dhe të drejtat e të akuzuarit dhe interesat për një gjykim të drejtë e të shpejtë.

12. Në përputhje me rregullën 113(6) të Rregullores, personave të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelit të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake brenda katërmëdhjetë ditësh nga dita e marrjes së njoftimit. Palët mund të kërkojnë leje për apelim të vendimit, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.

III. DISKUTIM

A. PARIMET E PROCESIT TË PARAQITJES SË KËRKESAVE PËR PRANIM SI VIKTIMË

13. Korniza ligjore e DHS-së parasheh disa hapa proceduralë që duhet të merren nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, palët dhe, mbrojtësi i viktimave, kur është e zbatueshme, në periudhën midis paraqitjes së parë të të akuzuarit dhe dorëzimit të dosjes Trupit Gjykues, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores. Njëri nga këta hapa ka të bëjë me vendimet në lidhje me kërkesat për pranimin si viktimë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, siç përcaktohet në rregullën 95(2)(i) të Rregullores.

14. ZPV-ja luan rol qendror në procesin e paraqitjes së kërkesave për pranim si viktimë, ndër të tjera, përmes mbledhjes së kërkesave dhe dorëzimit të tyre Gjykatësit të Procedurës Paraprake, përmes dhënies së rekomandimeve në lidhje me pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët si dhe në lidhje me kërkesat për masa mbrojtëse për parashtruesit e kërkesave. Në aspekte të ndryshme të procesit të paraqitjes së kërkesave për pranim si viktimë mund të përfshihen edhe njësi të tjera të Zyrës Administrative. Gjithashtu, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) duhet t’i japë ZPV-së emrat e të gjithë personave që kanë pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përshkruar në Aktakuzën e Konfirmuar. Për të siguruar efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit të paraqitjes së kërkesave të viktimave dhe për të ndihmuar ZPV-në dhe të gjithë palët e tjera të përfshira në proces, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme të ofrojë orientime të hollësishme dhe në kohë, me udhëzime të qarta dhe racionale për zbatimin e dispozitave përkatëse.⁷

15. Për më tepër, për t’i mundësuar ZPV-së që të ushtrojë funksionet e saj siç përcaktohet në nenin 34(6) të Ligjit dhe rregullën 113(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e sheh të përshtatshme t’i lejojë ZPV-së qasje në versionet e paredaktuara të Aktakuzës së Konfirmuar dhe të Vendimit të Konfirmimit⁸. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPV-së klasifikimin rreptësisht konfidencial të parashtrimeve të protokolluara të përmendura më lart dhe e

⁷ Shih KSC-BC-2020-05, F00055, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat* (“Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen Mustafa”), 27 nëntor 2020, publik, para. 14. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, Pre-Trial Chamber II, *Decision Establishing Principles on the Victims’ Application Process* (“Ntaganda Principles Application Process”), ICC-01/04-02/06-67, 28 maj 2013, para. 3; *Prosecutor v. Ongwen*, Pre-Trial Chamber II, *Decision Establishing Principles on the Victims’ Applications Process* (“Ongwen Principles Application Process”), ICC-02/04-01/15-205, 4 mars 2015, para. 1-2.

⁸ Parashtrimet e protokolluara për të cilat bëhet fjalë janë: KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00010/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

udhëzon të mos i japë informacion asnjë personi pa redaktimet që përmbajnë versionet përkatëse publike.⁹

16. Duke pasur parasysh faktin që në parashtrimet e lartpërmendura ZPV-së i bëhen të ditur emrat e viktimave të mundshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake saktëson se informacioni që ZPS-ja duhet t'i japë ZPV-së për çdo person që ka pësuar dëm duhet të përmbajë, për aq sa është e mundur, të dhënat e kontaktit të atyre personave në mënyrë që t'i mundësojë ZPV-së të kontaktojë me ta.¹⁰ Gjithashtu, ZPS-ja duhet t'i japë ZPV-së çdo informacion ose rekomandim tjetër të nevojshëm në lidhje me sigurinë e parashtruesve të kërkesave, që ZPV-ja të mund të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë të plotë dhe me vëmendjen e duhur ndaj aspekteve mbizotëruese të sigurisë.¹¹

B INFORMACIONI QË U JEPET PERSONAVE QË DUAN TË PARASHTROJNË KËRKESË

17. Është me rëndësi kritike të ndërmerren veprime efikase dhe me kohë për ndërgjegjësim dhe komunikim për të informuar kandidatët e mundshëm mbi mandatin e DHS-së dhe sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në proces.¹² Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake këshillon që, kurdoherë që është e realizueshme, ZPV-ja duhet t'u ofrojë kandidatëve të mundshëm informacion të plotë, të saktë, konciz dhe të disponueshëm, në lidhje me, ndër të tjera: (i) mandatin e DHS-së; (ii) parametrat materialë, kohorë dhe gjeografikë të veprave penale të konfirmuara në Aktakuzën e DHS-së, për aq sa lejojnë redaktimet e zbatuara; (iii) hapat e procesit të parashtrimit të kërkesës; (iv) veçoritë kryesore të sistemit të pjesëmarrjes së viktimave në proces; dhe

⁹ *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 15.

¹⁰ *Shih*, KSC-BC-2020-06, F00382, *Vendim i dytë kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat* ("Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*."), 6 korrik 2021, publik, para. 17.

¹¹ *Shih*, Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 17.

¹² *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 16. *Ngjashëm*, ICC, *Ntaganda Principles Application Process*, para. 12; *Ongwen Principles Application Process*, para. 10.

(v) sistemin e zhdëmtimit të DHS-së.¹³ ZPS-ja dhe njësi të tjera të Zyrës Administrative mund të ofrojnë ndihmë në këtë proces, në bashkërendim me ZPV-në.¹⁴

C. MBLEDHJA E KËRKESAVE

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, kurdoherë që është e realizueshme, ZPV-ja duhet t'i ndihmojë parashtruesit e kërkesave në plotësimin e formularit katërfaqësh të "Kërkesës për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces", që mund të gjendet në faqen e internetit të DHS-së ("formulari i kërkesës"). Kjo ndihmë, që jepet personalisht ose nga distanca, sipas rastit, duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së formularit të kërkesës dhe procesit të paraqitjes së kërkesës dhe, nëse është e nevojshme, udhëzime për plotësimin e pjesëve të veçanta të formularit të kërkesës.¹⁵ Sidoqoftë, viktimat janë gjithashtu të lira ta plotësojnë formularin e kërkesës vetë, ose me ndihmën e mbrojtësit. Ndërsa parashtruesit e kërkesave inkurajohen të paraqesin formularë të kërkesave individualisht, kjo nuk e ndalon një grup parashtruesish që kanë pësuar dëme të ngjashme si pasojë e drejtpërdrejtë e të njëjtit krim, si p.sh., anëtarët e familjes, që të përdorin së bashku një formular të vetëm kërkesë. Sidoqoftë, në këtë rast, duhet të përmbushen kriteret e plotësisë së kërkesës për secilin parashtrues kërkesë, siç përcaktohet në paragrafin 24.¹⁶

19. Përveç formularit të kërkesës në formatin e zakonshëm, parashtruesve të kërkesave për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces duhet t'u vihet në

¹³ *Shih* Vendim mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 16. *Ngjashëm*, ICC, *Ntaganda Principles Application Process*, para. 13; *Ongwen Principles Application Process*, para. 12; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaissona*, Pre-Trial Chamber II, *Decision Establishing the Principles Applicable to Victims' Application for Participation*, ICC-01/14-01/18-141, 5 mars 2019, para. 12.

¹⁴ *Shih* Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 18.

¹⁵ *Shih* Vendim mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 17. *Ngjashëm*, ICC, *Ntaganda Principles Application Process*, para. 26; *Ongwen Principles Application Process*, para. 23.

¹⁶ Secilit parashtrues kërkesë në formularin e kërkesës së plotësuar bashkërisht i caktohet një pseudonim më vete, siç përcaktohet në paragrafin 23.

dispozicion edhe një formular elektronik i kërkesës, i njëjtë për nga përmbajtja me të parin, që mund të shkarkohet dhe plotësohet elektronikisht. Nuk është e nevojshme që parashtruesi i kërkesës të japë arsye për përdorimin e formularit elektronik të kërkesës. Përkundrazi, me synimin për të lehtësuar angazhimin e viktimës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë mundësi të zgjedhë që ose ta plotësojë formularin e kërkesës në letër, ose të përdorë versionin elektronik të tij.¹⁷

20. Për sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në të raportojë për mënyrën e dorëzimit të kërkesave,¹⁸ numrin e kërkesave të dorëzuara dhe periudhën kohore brenda së cilës janë dorëzuar, siç përcaktohet në paragrafin 30.

D. DORËZIMI I KËRKESAVE

21. Kërkesat mund t'i dorëzohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake deri dy javë para paraqitjes prej Mbrojtjes të parashtrimin sipas rregullës 95(5) të Rregullores, që është afati i fundit për dorëzimin e kërkesave gjatë fazës së procedurës paraprake. Pas kësaj date, ZPV-ja mund t'ia dorëzojë kërkesat Trupit Gjykues në pajtim me vendimet e atij Trupi Gjykues.

22. Në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, para paraqitjes së kërkesave Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZPV-ja duhet t'i regjistrojë dhe shqyrtojë kërkesat e marra. Kjo nënkupton një proces në të cilin ZPV-ja (i) i regjistron kërkesat e marra dhe i cakton një pseudonim çdo parashtruesi kërkesë; (ii) shqyrton përmbajtjen e kërkesave të marra për të identifikuar informacionin që mungon ose që është i paplotë dhe/ose i pasaktë; (iii) nëse është e nevojshme, i drejtohet parashtruesit të kërkesës duke kërkuar informacion ose material shtesë

¹⁷ *Shih*, Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 24.

¹⁸ Kjo mund të përfshijë, për shembull, nëse kërkesat janë dërguar me postë, email ose janë dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës personalisht, ose përmes një pale të tretë.

për plotësimin e kërkesës; dhe (iv) i përgatit kërkesat për dorëzim, siç përcaktohet më poshtë.

23. Sa u përket pseudonimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në që të caktojë nga një numër për çdo parashtrues kërkesë, pavarësisht nëse parashtruesi i kërkesës ka kërkuar ose nuk ka kërkuar masa mbrojtëse. Pseudonimi i caktuar në këtë mënyrë duhet të përdoret si i vetmi identifikues i viktimës në publik dhe në parashtrimet e protokolluara (rreptësisht) konfidenciale, përveç nëse paneli kompetent urdhëron ndryshe.¹⁹

24. Që një kërkesë të konsiderohet e plotë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se duhet të përmbushen së paku kriteret në vijim: (i) ka prova të mjaftueshme për identitetin dhe, nëse ka lidhje, lidhjen familjare dhe/ose kujdestarinë ligjore; (ii) të dhënat personale janë të plota; (iii) të gjitha pjesët e formularit të kërkesës janë plotësuar; (iv) data/periudha dhe vendndodhja e krimit, si dhe dëmi i pësuar janë shënuar mjaftueshmërisht qartë; (v) është paraqitur dokumentacion i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm për atë që ka qenë e mundur; dhe (vi) kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor i tij/saj.²⁰

25. Sa i përket kriterit të fundit, duke marrë parasysh nevojën për identifikimin e parashtruesve të kërkesave dhe verifikuar vërtetësinë e formularëve të tyre, por duke mbajtur gjithashtu parasysh praktikën e sotme në Kosovë lidhur me nënshkrimin e dokumenteve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nënshkrimi në formularin e kërkesës mund të jetë: (i) i shkruar me dorë (parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor shkruan emrin e tij/saj ose vë një shenjë në dokumentin fizik të formularit të kërkesës); ose (ii) elektronik (parashtruesi i kërkesës ose kujdestari ligjor përdor nënshkrimin e tij apo të saj të përfutur në mënyrë digjitale, ose vendos apo bashkëngjit në kopjen elektronike të

¹⁹ *Shih*, Vendim mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 21.

²⁰ *Shih*, Vendim mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 22.

formularit të kërkesës një pamje digjitale të nënshkrimit (kopje të skanuar, fotografi të bërë, për shembull, me telefon celular)). Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon që, si nënshkrimet me dorë, ashtu edhe ato elektronike të përshkruara më lart, mund të pranohen si të vlefshme.²¹

26. Marrja e nënshkrimit në mënyrat e përshkruara më lart mund të bëhet edhe pas dorëzimit të formularit përkatës nga parashtruesi i kërkesës dhe ZPV-ja mund t'u ofrojë ndihmë parashtruesve të kërkesave në lidhje me këtë. Formulari i kërkesës që i dorëzohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, përmban në çdo rast nënshkrimin e kërkuar.²²

27. ZPV-ja duhet të përpiqet që t'i paraqesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake vetëm kërkesa të plota. Për këtë qëllim, ZPV-ja duhet t'i kontrollojë kërkesat shpejt dhe, nëse është e nevojshme, t'i kontaktojë parashtruesit e kërkesave për të kërkuar informacion ose material shtesë për plotësimin e kërkesave.

28. Këto udhëzime nënkuptojnë që ZPV-ja duhet gjithmonë të kërkojë informacion nga parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje si viktimë nëse ato disponojnë dokumentacion përkatës dhe të mjaftueshëm në mbështetje të kërkesës së tyre dhe, nëse po, ZPV-ja duhet të kërkojë dorëzimin e atij materiali.²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej saktëson se ZPV-ja duhet të bëjë përpjekje për të siguruar këtë lloj dokumentacioni përpara dërgimit të raportit të saj të përmendur më poshtë Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në mënyrë që të shmangë, për aq sa është e mundur, vonesat e shkaktuara nga paraqitja e parashtrimeve plotësuese dhe/ose shtyrja e vendimeve.²⁴

²¹ *Shih*, Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 25-26.

²² *Shih*, Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 28.

²³ *Shih*, Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 20. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00257/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 21 prill 2021, publik, para. 35 dhe poshtëshënimi 26.

²⁴ *Shih* Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 20.

29. Nëse, sipas mendimit të ZPV-së, kërkesa është qartësisht jashtë kuadrit të akuzave të konfirmuara, gjithsesi ZPV-ja duhet të sigurohet se janë përmbushur kushtet (i)-(iv) dhe (vi) të paragrafit 24. Nëse, me gjithë përpjekjet maksimale të ZPV-së, kërkesa nuk mund të plotësohet, ZPV-ja duhet megjithatë t'ia dorëzojë kërkesën Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke vënë në dukje masat që janë marrë për plotësimin e kërkesës dhe arsyet e mosplotësimit. Në fund të fundit, të gjitha kërkesat, të plota ose jo, duhet t'i dorëzohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake, përveç nëse tërhiqen nga parashtruesit e kërkesave.

30. Sa i përket përgatitjes për dorëzimin e kërkesave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja duhet të paraqesë një parashtrim përmbledhës ("raport për GJPP-në"),²⁵ që konkretisht përfshin:

- (a) një raport që përmban:
 - (i) mënyrën në të cilën janë marrë kërkesat, numrin e kërkesave të marra dhe kohën në të cilën janë marrë ato kërkesa;
 - (ii) veprimet kryesore të ndërmarra nga ZPV-ja për të përcaktuar plotësinë e kërkesave;
 - (iii) numrin, sipas rastit, të: (i) kërkesave të plota të paraqitura dhe (ii) kërkesave të paplota të paraqitura dhe një përmbledhje të arsyeve pse ZPV-ja ka vendosur që megjithatë t'i dorëzojë ato. Në raportin e vet të fundit për GJPP-në, para afatit të fundit të përmendur në paragrafin 21, ZPV-ja duhet gjithashtu të bëjë të ditur numrin e të gjitha kërkesave të paplota që nuk janë dorëzuar dhe nëse ZPV-ja parashikon veprime të mëtejshme për të siguruar që ato të jenë të plota;

²⁵ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 24.

- (b) një përmbledhje të rekomandimeve në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në paragrafët 34-46;
- (c) një përmbledhje të rekomandimeve në lidhje me ndarjen në grupe për përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në paragrafët 48-50;
- (d) një përmbledhje të masave mbrojtëse të kërkuara, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në paragrafët 52-55;
- (e) shtojcat, si vijon:
 - (i) një shtojcë me tabela konfidenciale dhe *ex parte* që përmbajnë, sipas rastit, numrin dhe të dhënat e parashtruesve të kërkesave që rekomandohet të pranohen – Grupi A, që nuk rekomandohet të pranohen – Grupi B, ose në lidhje me të cilët ZPV-ja nuk jep rekomandim – Grupi C;
 - (ii) shtojcat konfidenciale dhe *ex parte*, për çdo kërkesë të paraqitur, që përmbajnë një “përmbledhje të kërkesës” koncize të përgatitur nga ZPV-ja. “Përmbledhja e kërkesës” duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në paragrafët 34-55:
 - a. pseudonimin që i është caktuar parashtruesit të kërkesës;
 - b. të dhënat personale të parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë mbiemrin, emrin, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, gjuhën (gjuhët) që flet dhe nëse parashtruesi i kërkesës është viktimë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë;
 - c. një përshkrim të hollësishëm por konciz të ngjarjes (ngjarjeve), duke përfshirë parametrat gjeografikë dhe kohorë, që kanë të bëjnë me krimin (krimet) e përmendura në Aktakuzën e

- Konfirmuar, dhe kryesin (kryesit) ose grupin (grupet) që janë përgjegjës, nëse dihen;
- d. dëmet e pësuar, përfshirë një përmbledhje të dokumentacionit të paraqitur për të dëshmuar dëmin e pësuar, për aq sa është i disponueshëm, dhe shkakësinë midis ngjarjes (ngjarjeve) dhe dëmit të pësuar;
 - e. rekomandimin e ZPV-së në lidhje me pranueshmërinë;
 - f. sipas rastit, kërkesën e parashtruesit për masa mbrojtëse dhe vlerësimin dhe rekomandimin e ZPV-së në lidhje me të; dhe
 - g. rekomandimin e ZPV-së në lidhje me ndarjen në grupe, duke treguar prejardhjen, gjuhën, vendndodhjen gjeografike, konfliktet e mundshme të interesit të parashtruesit të kërkesës, si dhe preferencat/opinionet e deklaruara nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me përfaqësimin juridik.

31. Njëkohësisht me paraqitjen e raportit për GJPP-në, ZPV-ja kalon në sistemin elektronik *Legal Workflow* edhe dokumentet e mëposhtme konfidenciale dhe *ex parte*:

- (a) formularin e kërkesës,²⁶ që përmban të njëjtin pseudonim për parashtruesin e kërkesës me atë që është dhënë në përmbledhjen e kërkesës përkatëse që i bashkëngjitet formularit; dhe
- (b) dokumentacionin mbështetës, nëse ka, të dërguar elektronikisht, të organizuar dhe të identifikuar në një mënyrë të tillë që tregon qartë parashtruesin e kërkesës të cilit i përket.²⁷

²⁶ Në sistemin elektronik *Legal Workflow*, çdo Subjekt Viktimë (kategori e meta të dhënave në *Legal Workflow*) në listën e dokumenteve duhet të ketë formularin përkatës të kërkesës. Formularët e kërkesës në Grupet A dhe C duhet të kalohen në *Legal Workflow* me përkthimin e miratuar nga redaktori gjuhësor. Formularët e kërkesës në Grupin B mund të kalohen në *Legal Workflow* me përkthimin paraprak ose të miratuar nga redaktori gjuhësor.

²⁷ Në sistemin elektronik *Legal Workflow*, i gjithë dokumentacioni mbështetës që i përket Subjektit Viktimë duhet të përfshihet në një listë me numra. Kur i njëjti dokument i takon më shumë se një

32. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron gjithashtu se ZPV-ja duhet t'i paraqesë periodikisht raporte të tilla GjPP-së, në përputhje me afatet e përcaktuara në paragrafin 63.

E. VLERËSIMI I KËRKESAVE

33. ZPV-ja udhëzohet që të kryejë vlerësimin paraprak në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave, ndarjen në grupe të parashtruesve të kërkesave dhe masat mbrojtëse të kërkuara.

1. Pranueshmëria e kërkesave

34. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullat 2, 113(1) dhe (4) të Rregullores, viktima parashtrues i kërkesës lejohet të marrë pjesë në proces nëse ka prova *prima facie* se:

- (a) parashtruesi i kërkesës është person fizik;
- (b) parashtruesi i kërkesës ka përshkruar në kërkesë veprime që duket se përbëjnë vepër penale brenda kuadrit të Aktakuzës së Konfirmuar;
- (c) parashtruesi i kërkesës ka pësuar dëm personalisht; dhe
- (d) dëmi ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.²⁸

Subjekti Viktimë, ai dokument përfshihet në listë për secilin nga ato subjekte viktimë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton ZPV-në t'i kalojë përkthimet paraprake të të gjithë materialit mbështetës në *Legal Workflow*, për aq sa është e realizueshme.

²⁸ *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 27.

(a) Standardi i vërtetimit: provat *prima facie*

35. Sipas rregullës 113(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton informacionin e paraqitur dhe materialin mbështetës mbi bazën e dhënies së provave *prima facie*.²⁹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shqyrton informacionin e paraqitur dhe materialin mbështetës rast pas rasti,³⁰ duke marrë parasysh: (i) të gjitha rrethanat përkatëse, siç duken në shikim të parë;³¹ dhe (ii) koherencën e brendshme të kërkesës.³²

(b) Personi fizik

36. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 të Rregullores, vetëm personat fizikë lejohen të marrin pjesë si VPP në proceset e DHS-së. Rrjedhimisht, personat juridikë janë të përjashtuar nga pjesëmarrja. Për të paraqitur kërkesë të vlefshme, personi fizik duhet të ketë aftësi juridike.³³ Siç është vënë në dukje në formularin e kërkesës, parashtruesi i kërkesës që është nën moshën 18 vjeç ose që është shpallur juridikisht i paaftë, duhet të përfaqësohet nga prindi ose kujdestari ligjor.³⁴

²⁹ Shprehja *prima facie* do të thotë “në shikim të parë; në dukje; ashtu siç duket në shikim të parë pa bërë hetime”. *Shih* OED Online, Oxford University Press, shtator 2020, Internet, 30 gusht 2021, <https://www.oed.com/view/Entry/151264?redirectedFrom=prima+facie#eid>.

³⁰ *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 28. Ngjashëm, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, Pre-Trial Judge, *Decision on Victims’ Participation in the Proceedings* (“*Ayyash et al. Decision on Victim Participation*”), STL-11-01/PT/PTJ, 8 maj 2012, para. 62.

³¹ *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 28. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, Pre-Trial Chamber I, *Decision on Victim’s Participation and Victims’ Common Legal Representation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings* (“*Gbagbo Decision on Victim Participation*”), ICC-02/11-01/11-138, 4 qershor 2012, para. 21.

³² *Shih*, Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 28. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Bemba*, Pre-Trial Chamber III, *Fourth Decision on Victims’ Participation* (“*Bemba Fourth Decision on Victim Participation*”), ICC-01/05-01/08-320, 12 dhjetor 2008, para. 31; *Gbagbo Decision on Victim Participation*, para. 21.

³³ *Shih* Ligjin Nr. 2004/32 mbi Ligjin për Familjen, ku në nenin 15(2)-(3) përcaktohet se aftësia juridike fitohet në moshën 18 vjeç.

³⁴ Formulari i kërkesës, Pjesa 4.

37. Parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin si dëshmi të identitetit: (i) dokumente identifikimi shtetërore, si letërnjoftim, pasaportë, leje qëndrimi, patentë e shoferit; dhe (ii) kur dokumentet e identifikimit nuk janë të disponueshme, çfarëdo dokumenti tjetër të besueshëm që përmban informacion që e identifikon parashtruesin e kërkesës, si certifikatë mjekësore, dokumente identifikuese nga vendi i punës, dokumentacion i lëshuar nga autoritetet lokale. Kur parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga prindi ose kujdestari ligjor, si dëshmi e kujdestarisë ligjore mund të paraqiten dokumentet në vijim: certifikatat e lindjes, letërnjoftimet që përmbajnë të dhënat e prindit ose kujdestarit ligjor, vendimet gjyqësore mbi kujdestarinë, dokumentacion tjetër i lëshuar nga autoritetet lokale ose shtetërore.³⁵

(c) Vepra (veprat) penale të pretenduara

38. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 113(4) të Rregullores, parashtruesi i kërkesës duhet të deklarojë se ka qenë viktimë e një ose më shumë veprave penale të përfshira në aktakuzë. Në këtë kontekst, “vepër penale” është cilado prej veprave penale të pasqyruara në Aktakuzën e Konfirmuar. Parashtruesi i kërkesës duhet të përshkruajë, me sa më shumë hollësi që është e mundshme, vendin dhe kohën e ngjarjes dhe, nëse është e mundshme, çdo kryes të veprave të pretenduara, të pranishëm në vendngjarje ose të përfshirë në ngjarje.³⁶

³⁵ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 30. *Ngjashëm, Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 33-34.

³⁶ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 31.

(d) Ka pësuar dëm personalisht

39. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 dhe 113(4) të Rregullores, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë pësuar personalisht dëm, duke përfshirë dëmin fizik, mendor ose material, si pasojë e drejtpërdrejtë e veprave penale të përfshira në aktakuzë.

40. Sa i përket dëmit që është pësuar *personalisht* nga viktimat, kjo nënkupton kushtin që dëmi të jetë pësuar nga parashtruesi i kërkesës, me fjalë të tjera janë shkaktuar pasoja mbi mirëqenien e vet fizike ose psikologjike ose gjendjen ekonomike. Këtu mund të përfshihen dëmet e pësuar nga viktimat që kanë qenë objekt i veprimeve të kryesve ("viktimat e drejtpërdrejta")³⁷ ose të pësuar nga individët në marrëdhënie të afërt me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë ose lënduar nga kryesit ("viktimat e tërthorta").³⁸

41. Sa u përket dëmeve fizike, parashtruesit e kërkesave duhet të japin përshkrimin e lëndimit konkret trupor, duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, për llojin, sa i rëndë është lëndimi, pjesën e trupit dhe numrin e lëndimeve, si dhe pasojat e tyre mbi shëndetin, aftësinë për të punuar dhe mirëqenien e viktimës.³⁹ Si dëshmi të dëmit fizik, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, certifikata mjekësore

³⁷ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 33. *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, Appeals Chamber, *Judgment on the Appeals of the Prosecutor and the Defence Against Trial Chamber I's Decision on Victims' Participation of 18 January 2008* ("Lubanga Appeal Decision on Victim Participation"), ICC-01/04-01/06-1432, 11 korrik 2008, para. 1, 32; *Prosecutor v. Lubanga*, Trial Chamber I, *Redacted Version of "Decision on 'Indirect Victims'"* ("Lubanga Decision on Indirect Victims"), ICC-01/04-01/06-1813, 8 prill 2009, para. 44; ECCC, *Co-Prosecutors v. Kaing*, Supreme Court Chamber, *Appeal Judgment ("Duch Appeal Judgment")*, 001/18-07-2007-ECCC/SC, 3 shkurt 2012, para. 416; STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 39.

³⁸ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 33. *Ngjashëm*, ICC, *Lubanga Appeal Decision on Victim Participation*, para. 1, 32; *Lubanga Decision on Indirect Victims*, para. 44, 50; *Prosecutor v. Abdallah Banda*, Trial Chamber IV, *Decision on 19 Applications to Participate in the Proceedings*, ICC-02/05-03/09-528, 12 dhjetor 2013, para. 26; ECCC, *Duch Appeal Judgment*, para. 417; STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para 39; *Prosecutor v. Ayyash*, Pre-Trial Judge, *Decision Relating to Victims' Participation in the Proceedings and Their Legal Representation* ("2020 Ayyash Decision on Victim Participation"), STL/18/10-PT-PTJ, 17 prill 2020, para. 25.

³⁹ Formulari i kërkesës, Pjesa 2.3.

(dokumentacion spitalor, radiografi ose rezultate të skanimeve të tjera, raporte të mjekëve, etj.), receta për barna, fotografi ose dokumentacion tjetër si dëshmi të lëndimeve trupore.⁴⁰

42. Sa i përket dëmit mendor, parashtruesit e kërkesave duhet të japin përshkrimin e vuajtjeve psikologjike konkrete, duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, për llojin, sa të rënda janë, dhe simptomat, si dhe pasojat në shëndetin, aftësinë për të punuar dhe mirëqenien e viktimës.⁴¹ Si dëshmi të dëmit mendor, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, dëshmi të lëshuara nga profesionistë të kualifikuar, si mjekë, psikologë, psikiatër ose këshilltarë psikologjikë, ose çfarëdo dokumentacioni tjetër që dëshmon për vuajtjet psikologjike.⁴²

43. Sa i përket dëmit material, parashtruesit e kërkesave duhet të japin përshkrimin e pronës konkrete ose të dëmit ose humbjes financiare, duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, të numrit dhe kategorisë/llojit të gjërave të dëmtuara, të shkatërruara ose të humbura, llojin dhe përmasat e dëmit ose humbjes së pësuar, si dhe pasojat në të ardhurat e viktimës.⁴³ Si dëshmi të dëmit material, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, dokumentacionin që dëshmon për pronën personale dhe/ose të ardhura të mëhershme së bashku me dokumentacionin që demonstroi dëmin material të pësuar, siç janë kërkesat për dëmshpërblim nga sigurimet, përlllogaritjet ose faturat për riparime, fotografitë, faturat e ndihmave për të papunët, dhe dokumente të tjera përkatëse.⁴⁴

⁴⁰ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 34. *Ngjashëm*, STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 67; 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 36.

⁴¹ Formulari i kërkesës, Pjesa 2.3.

⁴² *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 35. *Ngjashëm*, STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 79; 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 43.

⁴³ Formulari i kërkesës, Pjesa 2.3.

⁴⁴ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 36. *Ngjashëm*, STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 74-75; 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 38-40.

(e) Rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në aktakuzë

44. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 dhe 113(4) të Rregullores, dëmi i pësuar duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në aktakuzë.

45. Dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale kur, në rrethanat që kanë ekzistuar në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë parasysh gjendjen personale të viktimës, veprimet ose mosveprimet e kryesit (kryesve) me shumë gjasë do ta shkaktonin atë dëm, parë nga këndvështrimi i një vëzhguesi objektiv.⁴⁵ Parashtruesit e kërkesave duhet të tregojnë lidhjen shkakore midis dëmit dhe veprës penale të përshkruar në Aktakuzën e Konfirmuar duke bërë një përshkrim të ngjarjeve dhe duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, mbi veprimet dhe mosveprimet që shkaktojnë dëmin, vendin, kohën, zhvillimin dhe kohëzgjatjen e ngjarjeve, si dhe rrethana të tjera të rëndësishme.⁴⁶

(f) Rekomandimi i ZPV-së

46. ZPV-ja i dorëzon të gjitha kërkesat, pavarësisht nëse, sipas mendimit të saj, ato janë të pranueshme (Grupi A) ose jo (Grupi B) ose nëse duhet t'i lihet Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vendosur për to (Grupi C). Sidoqoftë, para dorëzimit të kërkesave, ZPV-ja mund t'i këshillojë parashtruesit e kërkesave në lidhje me kriteret e nenit 22(1) të Ligjit dhe mund t'u japë parashtruesve të kërkesave mundësinë që të plotësojnë ose tërheqin kërkesat, nëse dëshirojnë.

47. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që të paraqesë rekomandime mbi pranueshmërinë, duke marrë parasysh kriteret e lartpërmendura.

⁴⁵ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 38. *Ngjashëm*, *megjithëse në kontekstin e Statutit të Romës*: ICC, *Bemba* Fourth Decision on Victim Participation, para. 77.

⁴⁶ Formulari i kërkesës, Pjesa 2.2.

2. Ndarja në grupe e parashtruesve të kërkesave

48. Në pajtim me nenin 22(4) të Ligjit dhe rregullën 113(2) dhe (8) të Rregullores, ZPV-ja bën rekomandim për përfaqësim të përbashkët. Ajo mund të propozojë që parashtruesit e kërkesave të cilët janë rekomanduar të pranohen (Grupi A), ose në lidhje me cilët ZPV-ja ia ka lënë vendimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake (Grupi C), të formojnë një grup, të përfaqësuar nga një mbrojtës i përbashkët i viktimave, ose disa grupe, secili me përfaqësim të përbashkët. Për këtë qëllim, ajo mban parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 113(8) të Rregullores. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të rregullës 113(7) të Rregullores, Administratorja i cakton një mbrojtës një grupi viktimash pjesëmarrëse në proces.⁴⁷

49. Nevoja për t'i ndarë parashtruesit në më shumë se një grup del kur situata ose veçoritë e viktimave janë kaq të ndryshme sa që interesat e tyre janë të papajtueshme,⁴⁸ duke e bërë përfaqësimin e përbashkët të tyre të porealizueshëm. Megjithatë, vetëm pangjashmëria midis rrethanave personale të viktimave mund të mos jetë e mjaftueshme për të krijuar më shumë se një grup. Si rrjedhojë, fakti që viktimat kanë pësuar dëm në forma të ndryshme, kanë qenë objekt i krimeve të ndryshme, kanë përkatësi etnike të ndryshme, banojnë në rajone të ndryshme, kanë origjinë nga shtete të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme, kanë pikëpamje politike të ndryshme ose kanë interesa ose pikëpamje të tjera, me të cilat viktimat e tjera nuk pajtohen por as nuk i kundërshtojnë, mund të mos përlligjë automatikisht përfaqësimin e ndarë të tyre.⁴⁹ Anasjelltas, kur disa prej faktorëve

⁴⁷ *Shih* Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në *çështjen* *Thaçi dhe të tjerët*, para. 22.

⁴⁸ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen* *Mustafa*, para. 42. *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Abdallah Banda and Jerbo*, Trial Chamber IV, *Decision on Common Legal Representation*, ICC-02/05-03/09-337, 25 maj 2012, para. 42.

⁴⁹ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen* *Mustafa*, para. 42. *Ngjashëm*, STL, *Ayyash et al.* *Decision on Victim Participation*, para. 124. *Shih gjithashtu* ICC, *Prosecutor v. Ruto et al.*, Registry, *Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims*, ICC-01/09-01/11-243-Anx2, 1 gusht 2011, para.

të lartpërmendur përputhen me njëri-tjetrin, konkretisht, kur viktimat kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të ndryshme, të cilët kanë ndodhur në rrethana të ndryshme, në data të ndryshme dhe në vende të ndryshme, duke përdorur *modi operandi* të ndryshme dhe me cak individë të ndryshëm, ndarja e viktimave në më shumë se një grup mund të jetë e domosdoshme.⁵⁰ E njëjta gjë vlen kur një faktor themelor i bën interesat e tyre të papajtueshme, si në rastin kur disa nga viktimat u kanë shkaktuar dëme viktimave të tjera.⁵¹

50. Kur parashtruesit e kërkesave i bëjnë të ditur ZPV-së se ata kanë parapëlqim për një përfaqësues juridik të veçantë, ZPV-ja duhet të verifikojë gjithashtu: (i) nëse parashtruesi i kërkesës është përfaqësuar nga një mbrojtës në procedimet e kaluara që lidhen me çështjen përkatëse para DHS-së, dhe nëse është kështu, nëse parashtruesi i kërkesës ka ndonjë pritshmëri që të përfaqësohet nga i njëjti mbrojtës para DHS-së; dhe (ii) ndërsa informon parashtruesin e kërkesës se pikëpamjet e tij apo të saj përbëjnë vetëm një prej aspekteve që mbahen parasysh nga Administratorja për caktimin e mbrojtësit të viktimave,⁵² ZPV-ja verifikon nëse parashtruesi i kërkesës ka shqetësime në lidhje me caktimin e mundshëm të një përfaqësuesi juridik të ndryshëm nga ai që parashtruesi do të kishte parapëlqyer, dhe nëse po, cilat janë ato shqetësime.⁵³

2-3, 7-11; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, Registry, *Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims*, ICC-01/09-02/11-214-Anx2, 5 gusht 2011, para. 2-3, 8-12; *Prosecutor v. Abdallah Banda and Jerbo*, Registry, *Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims*, ICC-02/05-03/09-203-Anx2-Red, 25 gusht 2011, para 5.

⁵⁰ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 42. Ngjashëm, STL, 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 66.

⁵¹ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 42. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, Trial Chamber II, *Order on the Organisation of Common Legal Representation of Victims*, ICC-01/04-01/07-1328, 22 korrik 2009, para. 12(c); *Prosecutor v. Ntaganda*, Pre-Trial Chamber I, *Decision Concerning the Organisation of Common Legal Representation of Victims*, ICC-01/04-02/06-160, 2 dhjetor 2013, para. 10, 23.

⁵² *Shih* Pjesën 15 të Direktivës për Mbrojtësit.

⁵³ *Shih* Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 22.

51. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që të paraqesë rekomandimet mbi ndarjen në grupe për përfaqësim të përbashkët duke marrë parasysh kriteret e lartpërmendura. Këto rekomandime i dorëzohen GjPP-së së bashku me secilin raport, për të shmangur vonesat e shkaktuara nga parashtrimet plotësuese.⁵⁴

3. Masat mbrojtëse

52. Në pajtim me rregullat 80 dhe 113(2) dhe (5) të Rregullores, ZPV-ja bën rekomandime në lidhje me kërkesat e parashtruesve për masa mbrojtëse nëse janë të domosdoshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Këto rekomandime vlejné për të gjithë parashtruesit e kërkesave, konkretisht: (i) për parashtruesit e kërkesave që janë rekomanduar për t'u pranuar (Grupi A) dhe për ata për të cilët ZPS-ja ia ka lënë vendimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake (Grupi C); dhe (ii) për arsye të konfidencialitetit të procesit të parashtrimit të kërkesave, për të gjithë parashtruesit e kërkesave që janë refuzuar (Grupi B).⁵⁵

53. Në përputhje me rregullën 80(4)(a), (d) dhe (e) të Rregullores, masat përkatëse për këtë fazë të procesit janë si në vijim: fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese të personave nga dokumentacioni publik i DHS-së (rregulla 80(4)(a)(i)); mosnxjerrja për publikun e dokumentacionit që identifikon parashtruesin e kërkesës (rregulla 80(4)(a)(ii)); caktimi i një pseudonimi (rregulla 80(4)(a)(vi)); mosnxjerrja nga mbrojtësi i specializuar për të akuzuarin e materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të parashtruesit të kërkesës (rregulla 80(4)(d)); ose, në rrethana të jashtëzakonshme, dhe në varësi të garancive mbrojtëse të nevojshme, mosnxjerrja për palët e asnjë materiali të përmendur më lart (rregulla 80(4)(e)).

⁵⁴ *Shih* Vendimi i dytë mbi kërkesat e viktimave në *çështjen* *Thaçi dhe të tjerët*, para. 21.

⁵⁵ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen* *Mustafa*, para. 44.

54. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton standardin ligjor për të përcaktuar nëse një informacion i caktuar mund të mos i jepet palës marrëse,⁵⁶ me anë të të cilit vlerësohet nëse:

- (a) nxjerrja e informacionit në fjalë përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur;
- (b) masa mbrojtëse është rreptësisht e domosdoshme.⁵⁷ Si rrjedhojë, nëse janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa mbrojtëse më pak kufizuese, duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe
- (c) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.⁵⁸

55. Në rastin kur parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar masa mbrojtëse sipas rregullës 80, ZPV-ja udhëzohet që të bëjë rekomandime nëse duhen masa mbrojtëse dhe cilat masa mbrojtëse duhet të miratojë Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e tij, duke pasur parasysh fazën e procesit dhe faktorë të tjerë përkatës.⁵⁹

56. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që të paraqesë rekomandime për masa mbrojtëse që përmenden në paragrafin 53, duke mbajtur parasysh standardin ligjor të lartpërmendur.

⁵⁶ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të*, 30 prill 2021, publik, para. 78. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të*, 9 tetor 2020, publik, para. 76; KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të*, 23 nëntor 2020, publik, para. 85.

⁵⁷ Neni 21(6) i Ligjit.

⁵⁸ Rregulla 80(1) e Rregullores.

⁵⁹ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në çështjen *Mustafa*, para. 47.

F. ROLI I PALËVE NË PROCESIN E PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE

57. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në përputhje me rregullën 113(1) të Rregullores, informacioni në formularët e kërkesave nuk u bëhet i njohur palëve. Sidoqoftë, në bazë të rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja është e detyruar që t'u dorëzojë palëve një përmbledhje konfidenciale të raportit për GjPP-në ("raport për palët"). Ky raport dorëzohet njëkohësisht me raportin për GjPP-në; ndryshe, ZPV-ja mund të tregojë nëse raporti për GjPP-në mund të riklasifikohet që të mund t'u vihet në dispozicion palëve, me kusht që të mos përmbajë informacion identifikues që duhet të redaktohet. Raporti për palët duhet të përfshijë informacionin në vijim, duke mos dhënë informacion identifikues për parashtruesit e kërkesave:

- (a) një përmbledhje të procesit të mbledhjes së kërkesave;
- (b) numrin e gjithsejtë të kërkesave të marra dhe numrin e kërkesave të dorëzuara Gjykatësit të Procedurës Paraprake;
- (c) krimet ose vendet e krimeve të pretenduara dhe kryesin ose kryesit e pretenduar;
- (d) numrin e viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, kërkesat e të cilave janë dorëzuar, dhe llojin e dokumentacionit të paraqitur për të vërtetuar identitetin, lidhjen familjare, kujdestarinë;
- (e) llojet e dëmit të pretenduar dhe llojin e dokumentacionit të paraqitur për të vërtetuar këtë dëm;
- (f) një përmbledhje të rekomandimit të ZPV-së mbi pranueshmërinë, që përmban numrin e kërkesave që propozohet të pranohen (Grupi A), të refuzohen (Grupi B) ose t'i lihen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vendosur (Grupi C), me një përshkrim të përgjithshëm të arsyeve për secilin grup;

- (g) një përmbledhje të rekomandimeve të ZPV-së lidhur me ndarjen në grupe për përfaqësim të përbashkët, me një përshkrim të përgjithshëm të arsyeve për këtë, dhe
- (h) një përmbledhje të masave mbrojtëse të kërkuara dhe të rekomandimeve të ZPV-së për to.⁶⁰

58. Në bazë të raportit për palët dhe në pajtim me rregullën 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime në lidhje me aspektet ligjore mbi pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, konkretisht në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kriterëve të trajtuara në paragrafët 34-45 dhe 48-50.

59. Duke pasur parasysh se mosnxjerrja e informacionit për palët duhet të jetë në pajtim me të drejtat e të akuzuarve dhe drejtësinë e procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se rregulla 113(3) e Rregullores nuk i ndalon palët që të bëjnë parashtrime në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kriterëve të trajtuara në paragrafët 52-55 në lidhje me çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80(4)(a), (d) ose (e) të Rregullores.⁶¹

60. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i urdhëron palët që të dorëzojnë parashtrime mbi rekomandimet e ZPV-së në lidhje me pranueshmërinë, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse brenda dhjetë (10) ditësh pasi të jenë njoftuar mbi raportin për palët.

61. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej kujton se, në përputhje me rregullën 113(6) të Rregullores, palët mund të kërkojnë leje për të apeluar vendimin mbi pjesëmarrjen e viktimave, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.

⁶⁰ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 49.

⁶¹ *Shih* Vendimi mbi kërkesat e viktimave në *çështjen Mustafa*, para. 51.

G. MJETET JURIDIKE PËR KËRKESAT E REFUZUARA

62. Në përputhje me rregullën 113(6) të Rregullores, parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të apelojnë vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që refuzon kërkesat e tyre. Apelime të tilla duhet t'i paraqiten panelit të Gjykatës së Apelit brenda 14 ditësh nga vendimi për refuzimin e kërkesës. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në përputhje me rregullat 9(2) dhe 113(5) të Rregullores, afati i lartpërmendur fillon nga dita e parë e punës pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës mbi vendimin që refuzon pranimin në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton.⁶² Nëse viktimat brenda një grupi njoftohen për një vendim të tillë në data të ndryshme, afati për dorëzimin e apeleve sipas rregullës 113(6) të Rregullores fillon nga momenti kur secili parashtrues kërkesë merr njoftimin përkatës.⁶³

VENDIM

63. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** Administratoren t'i vërë në dispozicion ZPV-së versionet e paredaktuara të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Vendimit të Konfirmimit, sikurse përcaktohet në paragrafin 15;
- b. **URDHËRON** ZPV-në të mos i japë asnjë personi informacion pa redaktimet që përmbajnë versionet publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Vendimit të Konfirmimit;

⁶² Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA005/F00003, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi mocionin e mbrojtësit për sqarim dhe ndryshim të afatit* ("Vendimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me afatin"), 31 maj 2021, publik, f. 3.

⁶³ Vendimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me afatin, f. 3.

- c. **URDHËRON** ZPV-në të dorëzojë raportin për GJPP-në sipas udhëzimeve dhe orientimeve të përcaktuara në këtë vendim, deri të **premtën, më 1 tetor 2021;**
- d. **URDHËRON** ZPV-në t'u dorëzojë raportin palëve në të njëjtën kohë me raportin për GJPP-në ose të bëjë të ditur nëse raporti për GJPP-në mund të riklasifikohet që të mund t'u jepet palëve dhe, nëse është e mundshme, publikut;
- e. **URDHËRON** ZPV-në t'i paraqesë rregullisht raporte të tjera GJPP-së, nëse ka, jo më vonë se dy javë para dorëzimit të parashtrimit të Mbrojtjes, sipas rregullës 95(5) të Rregullores;
- f. **URDHËRON** ZPV-në t'u dorëzojë palëve raportet e tjera, në të njëjtën kohë me dorëzimin e raporteve të tjera për GJPP-në, siç përcaktohet në paragrafin 63(d); dhe
- g. **URDHËRON** Prokurorin e Specializuar dhe Mbrojtjen e të akuzuarve të dorëzojnë parashtrime në përputhje me rregullën 113(3) të Rregullores, nëse kanë, brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i çdo raporti palëve ose, sipas rastit, të dorëzojnë versionet e riklasifikuara të çdo raporti për GJPP-në.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 1 shtator 2021

Në Hagë, Holandë.